



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština – Assembly*

---

Legjislatura VI  
*Sesioni pranveror*

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,  
për Persona të Pagjetur dhe Peticione  
P-nr.27/2018

Prishtinë, më 11 korrik 2018

**PROCESVERBAL**

Në mbledhje morën pjesë: Duda Balje, Lirije Kajtazi, Sasha Milosavljeviç, Saranda Bogujevci, Luljeta Veselaj-Gutaj, Mexhide Mjaku-Topalli, Shemsi Sylja, Fisnik Ismaili dhe Teuta Haxhiu.

Munguan: Mirjeta Kalludra dhe Albulena Balaj- Halimaj.

Stafi mbështetës i komisionit: Selman Ymeri, koordinator dhe Sulltane Gashi, zyrtare e fushës.

Pjesëmarrës të tjerë: Skënder Reçica, ministër i MPMS, Mentor Morina, MPMS, Valon Leci, inspektor i punës, MPMS, Mentor Tershnjaku, MPMS; Albulena Shabani, Terre des hommes, Betim Zllomoga, Terre des hommes, Jezerca Tigani, Terre des hommes; Berita Abazi, LV; Aldisa Morina, asistente, AAK; Egzon Dobroshi, KDI; Ardian Klaiqi, UNICEF; Qëndresa Ibraj-Zariqi, ZQM/ZKM; Agron Gashi-ZKM/ZI; Alberita Hyseni, ZKM/ZL; Donjeta Kelmendi, KOMF; Mehmet Krasniqi, EO; Liridon Gashi, SPOR; Vaide Morina, Radio Kosova, Rabije Hyesni, Kuvend/zyra për informim; Albana Atashi, OJQ “Syri vizion” dhe Melita Kabashi, “Save the Children”.

Mbledhjen e kryesoi, Duda Balje, kryetare e komisionit.

Anëtarët e komisionit nuk patën vërejtje dhe as propozime të tjera për rendin e ditës, të propozuar nga kryetarja e komisionit, andaj komisioni i zhvilloi punimet me këtë

**Rend dite:**

1. Diskutim në komision lidhur me gjendjen ekzistuese e të rinjve dhe të miturve, të cilët punojnë në sektorin privat. Të ftuar: Skënder Reçica, ministër i Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Basri Ibrahim, kryeinspektor i Inspektoratit të Punës.

2. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-084 për mbrojtjen e fëmijës;

3. Të ndryshme.

**1. Diskutim në Komision lidhur me gjendjen ekzistuese e të rinjve dhe të miturve, të cilët punojnë në sektorin privat. Të ftuar: Skënder Reçica, ministër i Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Basri Ibrahim, kryeinspektor i Inspektoratit të Punës**

**Kryetarja**, tha se për këtë pikë të rendit të ditës kemi ftuar ministrin e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe nga Inspektoratit i Punës, lidhur me gjendjen ekzistuese e të rinjve dhe të miturve, të cilët punojnë në sektorin privat.

**Skënder Reçica**, tha se kjo temë ka një rëndësi të veçantë, sepse bëhet fjalë për angazhimin e të miturve apo atyre që janë nën moshën e lejuar për punë, veçanërisht të angazhuar në sektorin privat. MPMS është e përkushtuar për përmirësimin e mirëqenies së fëmijëve, në përgjithësi, sidomos ndalimin e formave të rrezikshme të punëve të fëmijëve, të cilat kanë ndikim në zhvillimin fizik, mendor, shpirtëror, moral, forma këto që pengojnë edukimin e fëmijëve. Që nga viti 2005 në Kosovë ekzistojnë strukturat e nevojshme për parandalimin dhe eliminimin e punës së rëndë të fëmijëve. Lidhur me këtë, janë hartuar një mori dokumentesh, përfshirë edhe Udhëzimin Administrativ nr.05/2013 për Parandalimin dhe Eliminimin e Punëve të Rënda të Fëmijëve, ndërsa aneks i veçante i këtij udhëzimi administrativ është edhe lista për punë të rënda. Në nivelin qendror mekanizëm koordinues është Komiteti Kosovar për Parandalimin dhe Eliminimin e Punëve të Rënda të Fëmijëve, që udhëhiqet nga ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale. Ky komitet, së paku dy herë brenda vitit mbledhet dhe debaton për çështjet që kanë të bëjnë me angazhimin e fëmijëve, përkatësisht fëmijëve që merren me punë të rënda, me qëllim të mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve. Qeveria e Kosovës, në muajin qershor të këtij viti, ka miratuar Projektligjin për mbrojtjen e fëmijës, ndërsa nga fillimi i këtij viti është filluar edhe hartimi i draft-strategjisë dhe planit të veprimit e të drejtave të fëmijëve 2018-2021, e cila është në proces të shqyrtimit nga Zyra e Kryeministrit, përkatësisht ZQM. Ministria e Punës ka hartuar raportin e përgjithshëm për fëmijët e identifikuar në punë të rënda, në pjesën e parë të këtij viti. Ky raport bazohet në raportet e konsoliduara nga qendrat për punë sociale, në të gjitha komunat e Kosovës. Në bazë të këtyre raporteve, rezulton se janë 52 fëmijë, në të gjitha komunat e Kosovës, të identifikuar, të cilët punojnë në punë të rënda. QPS-të njoftojnë se këtyre fëmijëve u janë ofruar këto shërbime: si shërbime këshillimi dhe vetëdijesimi për fëmijë, inkadrim në shkollë të rregullt, arsim joformal, trajnim, aftësim profesional, punësim në forma të lejuara për fëmijët 15-18 vjet, aplikim i masave të mbrojtjes, asistencë ligjore, aktivitete rekreative, shërbime shëndetësore, sigurimi i një shujte ushqimore në shkollë, libra etj.

MPMS ka ndërmarrë disa veprime për funksionalizimin e strukturave lokale me qëllim të parandalimit dhe eliminimit të punëve të rënda të fëmijët. Në muajin gusht pritet të nënshkruhet marrëveshja e bashkëpunimit në mes MPMS-së dhe kryetarëve të komunave, e cila ka për qëllim të rregullojë dhe të koordinojë aktivitetet e institucioneve në nivelin qendror dhe lokal për mbrojtjen e fëmijëve nga eksploatimi ekonomik dhe nga kryerja e punëve që pengojnë edukimin e tyre ose që janë të dëmshme për shëndetin e tyre. MPMS, përmes Inspektoratit të Punës, realizon masa tjera ligjore, duke inspektuar subjektet e ndryshme për

këtë çështje. Inspektorati i Punës mbikëqyrë edhe zbatimin e legjislacionit për marrëdhënien e punës, sigurinë dhe shëndetin në punë dhe aktet nënligjore, që dalin nga këto ligje.

Në lidhje me rastin që ka ndodhur në Prizren, ku si pasojë një person i moshës 17 vjeçare ka humbur jetën në vendin e punës, Inspektorati i Punës ka ndërmarrë të gjitha masat e parapara me ligj. Ndërsa, në afatin kohor, sipas legjislacionit në fuqi, do të hartojë raportin me të dhënat e sakta se çfarë realisht ka ndodhur. Aktualisht, këtij subjekti i është pezulluar puna, derisa të

zbardhen detajet nga raporti i Inspektoratit të Punës. Ky subjekt ka qenë i inspektuar më herët. Në vazhdim, theksoi se në Qeveri kemi miratuar draft-ligjin për Inspektoratin e Punës dhe së shpejti do të dërgohet në Kuvend. Ky projektligj i plotëson standardet e ONP-së dhe do të jetë më lehtë i zbatueshëm. Tani për tani kemi numër të vogël të inspektorëve dhe jemi duke bërë përpjekje që brenda këtij viti të shtohen edhe dhjetë inspektorë të tjerë dhe besojmë se jemi në rrugë të mirë, sa i përket ngritjes së vetëdijesimit për sigurinë dhe shëndetin në punë.

**Kryetarja**, tha se ju si ministri keni statistika për fëmijët e angazhuar në punë. Me ligj, fëmijët e kanë të ndaluar të bëjnë punë të rënda, dhe nëse inspektorët kanë dalë në terren dhe kanë konstatuar se një fëmijë është duke bërë punë të rënda, çfarë masash keni ndërmarrë për të mos ndodhur ndonjë e keqe dhe sa inspektorë keni në terren? Ajo u interesua të dijë se një fëmijë nënë moshën e lejuar për punë, si i bëhet kontrata për punë.

**Skënder Reçica**, sa i përket numrit të inspektorëve nuk e kemi numrin real të inspektorëve që kanë mundësi të bëjnë inspektimin, dhe në bazë të këtyre kapaciteteve, Inspektorati i Punës ka dyfishuar inspektimin. Janë 44 inspektorë që janë vazhdimisht në terren, çdo ditë dhe këtë vit pritet t'i kemi edhe dhjetë inspektorë të rinj dhe po ashtu edhe vitin e ardhshëm. Sipas standardeve ndërkombëtare, 80 inspektorë do të ishin të mjaftueshëm.

**Mexhide Mjaku-Topalli**, tha se a janë qytetarë të Republikës së Kosovës, këta fëmijë që kërkojnë lëmshë, sepse ndodh që për çdo dite i takojmë, qoftë në rrugë, qoftë diku tjetër. Në raportimet tuaja në Komisionin Funkcional, kam kërkuar të di se çka do të ndërmerreni lidhur me familjet që marrin asistencë sociale dhe në momentin kur fëmija mbush moshën 5 vjeçare, i ndërpritet kjo asistencë. Po ashtu, ajo u interesua të dijë edhe për ndihmesat për familjet dhe nënat që lindin fëmijë, të cilat janë të punësuar apo jo. Ajo pyeti se në cilat komuna është e theksuar më shumë puna e fëmijëve, si dhe po ndodh që shumë biznese nuk i kanë të lajmëruar të gjithë punëtorët, atëherë a është e vështirë të identifikohen këto probleme?

**Skënder Reçica**, të dhënat që i kemi, mund të flasin se nga ky numër prej 52 fëmijëve, mund të mos jenë të gjithë nga Kosova. Të gjitha këto raste trajtohen nga Policia e Kosovës dhe ne i kemi vetëm si shifra. Lidhur me pyetjen se në cilat komuna është më e theksuar puna të fëmijët, janë Komuna e Prishtinës dhe e Prizrenit. Sa i përket skemës sociale të familjet që kanë fëmijë në moshën 5 vjeçare, jemi duke punuar shumë në analizimin e situatës së skemës sociale në vend. Ndërsa, sa i përket informalitetit në punë, jo vetëm me fëmijë, por edhe me të

rritur, inspektorati çdo ditë ballafaqohet me këtë çështje dhe po përpiqemi që mos të lëmë kompani dhe biznes pa e vizituar, me qëllim të vetëdijesimit dhe parandalimit të informalitetit. Në koncept-dokumentin për draftligjin e punës dhe marrëdhënien në punë, kemi paraparë që t'i mbështesim financiarisht edhe lehonat që nuk punojnë.

**Saranda Bogujevci**, çfarë hapash ndërmerrni, kur punëdhënësi nuk i ka përmbushur kushtet për punëtorët sipas ligjit? Çka ndërmerret për të mos ardhur deri te shkelja e të drejtave të njeriut? Sepse, punëdhënësi i shmanget pagesës së tatimit, kontributit të punëtorëve etj.

**Skender Reçica**, qëllimi i inspektoratit nuk është të gjobisë ndërmarrje, por qëllimi është të rrisë vetëdijesimin, që mos të vijë deri te rasti i aksidenteve me fatalitet në vendin e punës dhe të respektohen ligjet.

**Luljeta Veselaj-Gutaj**, tha se konkretisht si ministri apo si Inspektorat i Punës, pasi që keni dalë në vendin e ngjarjes në Prizren, ku këto ditë, një rast ka përfunduar me fatalitet dhe keni parë nga afër se si ka ndodhur. Çka keni ndërmarrë ndaj kompanisë, e cila e ka pranuar në punë atë fëmijë? A ka qenë i njoftuar ai fëmijë, paraprakisht me rreziqet e punës, të cilat do t'i kryente dhe a lejohet për një moshë të tillë të punohet në një vend pune të atillë, me një makineri të rëndë?

**Skënder Reçica**, tha se i kanë të gjitha të dhënat sesi ka ndodhur aksidenti dhe është shqetësuese. Kjo kompani, për herë të fundit, është inspektuar në vitin 2015 dhe e kamë një raport që kompania nuk ka pasur ndonjë shkelje të ligjit për marrëdhënie në punë dhe ligjit për siguri dhe shëndetin në punë. Atë ditë, që ka ndodhur aksidenti, Inspektorati i Punës ka nxjerrë një vendim për pezullim të përkohshëm të veprimtarisë së asaj kompanie. Rasti është në procedura edhe të institucioneve të tjera dhe secili institucion duhet të përfundojë punën e vet dhe në fund edhe inspektorati del me raport final, lidhur me situatën sesi ka ndodhur deri te aksidenti.

**Fisnik Ismaili**, u tha se synimi është që të bëhen 80 inspektorë, që i plotëson kriteret sipas Komisionit Evropian, dhe nëse arrihet ky numër prej 80, sa do jenë efikas këta dhe sa janë efikas këta që janë aktual deri tani, sepse këtu ka shumë kompani që fshehin informatat, nuk bëjnë deklarin e saktë të numrit të punëtorëve. Ai u interesua për fushatën vetëdijësuese dhe efikasitetin e atij vetëdijesimi, si dhe u interesua të dijë se kush e ka bërë fushatën, sa ka kushtuar ajo fushatë dhe sa ka pasur efekt ajo.

**Skënder Reçica**, tha se fatkeqësisht po ndodhin raste me fatalitet në punë, edhe përkundër angazhimit. Nga dita e parë, jam munduar të fuqizoj rolin e inspektorëve. Lidhur me kapacitetet aktuale të inspektorëve, theksoi se nuk jam i kënaqur, jo me punën e tyre, por as me kushtet e tyre që ua ofrojmë për inspektim në terren. Sa i përket fushatës, nuk kemi lejuar të angazhojmë kompani. Pra, krejt çka kemi bërë, është se kemi bërë një spot me tri katër

mesazhe, që burojnë nga Ligji për sigurinë dhe shëndetin në punë dhe kjo nuk besoj se ka kaluar më shumë se 1000 euro, sepse është bërë me zyrën për informim, brenda ministrisë, ndërsa RTK është duke e publikuar vazhdimisht, pa kompensim, dhe kjo fushatë ka efekt.

**Teuta Haxhiu**, kërkoi që një raport me shkrim të dërgohet në komision, ndërsa më pas pyeti lidhur me Inspektoratin e Punës: Sa kompani monitorohen dhe në çfarë afati? A janë publike të dhënat, në mënyrë që të mund të jenë të qasshme edhe për qytetarët? Ajo theksoi se është mirë të fillohet inspektimi prej kompanive të deputetëve apo edhe të ministrave e të zyrtarëve të lartë.

**Skënder Reçica**, tha se është shtuar numri i inspektimeve në terren dhe jemi duke punuar me përkushtim të lartë për fuqizimin e rolit të Institucionit të Inspektoratit të Punës dhe të vetë punës së inspektorëve. Inspektorët i kemi të njëjtit, dy herë më shumë në terren, se më parë. Lidhur me raportet javore që i bën Inspektorati i Punës, në bazë të qasjes në dokumentet publike, secili qytetar ka qasje.

**Valon Leci**, tha se raportet zyrtare të Inspektoratit të Punës janë publike në ueb faqen e Inspektoratit të Punës, ndërsa emrat e firmave që janë inspektuar, nuk janë. Numri i gjobave ekziston, por nuk është për secilën firmë, sepse ndalohet të bëhen publike edhe me Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale edhe ka top sekrete afariste që neve na ndalohen t'i bëjmë publike.

**Shemsi Sylja**, tha se çfarë mund të bëni ju si ministër në qeverinë e juaj, që ta ndryshoni qasjen e qeverisë në këtë fushë, që të përqendrohet një vëmendje në të cilën do të gjejnë rrugë konkrete me të cilën do ta ndryshonin gjendjen. Çfarë do të bëjë me rastet e tjera nëse nuk merren masa konkrete, sa keni kontakt me ministrinë tjera si të arsimit e të tjera që ndërlidhen dhe të bëhet një rrugë e edukimit të këtij brezi që të mos bie pre e tragjedi që po na ndodhin.

**Skënder Reçica**, absolutisht nuk jam i kënaqur me gjendjen e sigurisë dhe shëndetit në punë, nuk jam i kënaqur as me gjendjen sociale në vend, jemi duke punuar për fuqizimin e qendrave për punë sociale. E dimë që nuk e kemi gjendjen mirë as me Ligjin e punës as me Ligjin për Inspektoratin e Punës, dhe tashmë, për këto të dyja, veç kemi filluar me procedurë për projektligje të reja, sepse me ato ekzistuese kemi problem zbatimin në praktikë. Jemi duke punuar në rritjen e vetëdijesimit për parandalimin e aksidenteve, po shqiptohen gjoba dhe kemi statistikat e sakta dhe çfarë gjobash shqiptohen për secilën kompani.

**Kryetarja**, tha se është mirë që të na i përcillni raportet, që ju i posedoni, lidhur me këto çështje. Në vazhdim, ajo kryesimin e mbledhjes ia dha nënkryetares së komisionit, znj. Lirije Kajtazi.

## **2. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-084 për mbrojtjen e fëmijës**

**Lirije Kajtazi**, tha se për prezantimin e këtij projektligji ia dha fjalën, z. Agron Gashit, koordinator në Zyrën Ligjore të Kryeministrit.

**Agron Gashi**, tha se ky projektligj është i bazuar në aktet legjislative të BE-së dhe në Konventën për të Drejtat e Fëmijëve dhe është në përputhshmëri me Direktivën 2011/92 të BE-së. Më tej, tha se është një projektligj i rëndësishëm, i cili ka kaluar të gjitha procedurat e shqyrtimit në Qeveri dhe përcakton rolet e institucioneve që merren me mbrojtjen e fëmijëve.

**Teuta Haxhiu**, tha se lidhur me këtë projektligj, pret një angazhim prej të gjithëve që të japin kontribut, që ta bëjmë një ligj sa me te kuptueshëm dhe sa më të mirë. Ndërsa, dilemat apo paqartësitë eventuale, lidhur me kompetencat dhe përgjegjësitë e institucioneve për këtë projektligj, do të sqarohen gjatë fazës së amendamentimit të projektligjit.

**Luljeta Veselaj-Gutaj**, u interesua të di se ky projektligj a ka ndryshime, në krahasim me draftin që ka qenë në mandatin e kaluar, sepse me sa po duket, është më voluminoz sesa mandatin e kaluar. Cilat janë ato ndryshime që i ka bërë Qeveria e tanishme në këtë projektligj?

**Lidhur me këtë projektligj, diskutoi edhe Qëndresa Ibraj**, nga ZQM, e cila tha se ndryshimet në këtë projektligj janë të mëdha. Janë shtuar edhe disa kaptina dhe janë përcaktuar mekanizmat institucionalë për të drejtat e fëmijëve, si në nivelin qendror, deri në nivelin komunal.

**Pas përfundimit të diskutimeve, nënkryetarja Lirije Kajtazi**, hodhi në votim Projektligjin për mbrojtjen e fëmijës.

Ajo konstatoi se nga 7 anëtarë të komisionit, të pranishëm, me vota unanime “Për”, Komisioni Funkcional nxori këtë:

### **Rekomandim**

Kuvendi të shqyrtojë dhe të miratojë, në parim, Projektligjin për mbrojtjen e fëmijës.

#### **1. Të ndryshme**

**Saranda Bogujevci**, kërkoi që ndaj ushtruesit të detyrës së drejtorit të Agjencisë Kadastrale të Kosovës, i cili, siç tha ajo, është akuzuar për ngacmim seksual në vendin e punës, ku rasti është i hapur që dy vite dhe ende është në proces. Ne, si komision, është mirë që të kërkohet shkarkimin e tij.

**Teuta Haxhiu**, tha se këto informata nuk i kemi të gjithë dhe është mirë që të gjitha ato informata që janë zyrtare, lidhur me këtë rast, të na i dërgoni, që të jemi më të informuar lidhur me këtë rast.

**Lirije Kajtazi**, tha se le të sigurohen informatat e duhura për këtë rast, se a është lënda në procedurë gjyqësore.

**Saranda Bogujevci**, tha se të gjitha materialet për këtë rast, do t'ua dërgoj përmes e-mailit.

Më pas, ajo informoi lidhur me vizitën e studentëve, përmes KFOR-it italian, të cilët kanë propozuar që të vizitojnë komisionin dhe Kuvendin, më dt. 20 korrik 2018. Ne do t'i presim do t'i informojmë lidhur me punën e komisionit, po ashtu kanë shprehur dëshirën që ta vizitojnë edhe sallën e Kuvendit të Kosovës. Ajo, gjithashtu, tha se si komision të marrim nismën për plotësim-ndryshimin e Ligjit për mbrojtje nga dhuna në familje, sidomos të bëhet harmonizimi me Kodin Penal.

**Mexhide Mjaku-Topalli**, tha se në mandatin e kaluar kemi kërkuar plotësim-ndryshimin e Ligjit për mbrojtje nga dhuna në familje, ku gjatë monitorimit të zbatimit të këtij ligji, në raport ka qenë ky rekomandim edhe në debatin parlamentar, po ashtu është kërkuar e njëjta gjë.

Më pas, ajo propozoi që të vizitojnë qendrat për punë sociale, si dhe familjet që marrin fëmijë në përkujdesje.

**Teuta Haxhiu**, tha se i kemi mbetur borxh shoqatës “27 Prilli” në Mejë, për të shkuar dhe për ta vizituar dhe të shohim punimet e kompleksit të varrezave më për së afërmi. Lidhur me këtë çështje, është mirë të propozohet një datë.

Ajo, po ashtu, lidhur me trajnimin e paraparë nga “Save the Children”, që do të mbahet në Strugë, tha se është me interes të jenë në atë trajnim. Sa i përket datave, ka kontaktuar me përfaqësues të kësaj organizate dhe ata kanë shprehur gatishmërinë që të kenë mirëkuptim, sa i përket ricaktimit të datave.

**Lirije Kajtazi**, tha se te gjitha këto çështje organizative do t'i akordojmë me administratën e komisionit.

Mbledhja përfundoi në orën 12:30.

*E përgatiti:*

*Stafi mbështetës i komisionit.*

Kryetarja e komisionit,

---

Duda Balje